



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
GUVERNATORI

Nr. 6476 prot.

Tiranë, më 24.12.2019

**VENDIM**

**Nr. 6476, datë 24.12.2019**

**PËR  
CAKTIMIN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 2, shkronja ‘b’; nenit 11, pikat 1 dhe 7; nenit 12, pika 3; nenit 14, pikat 5, 6, 7, 8 dhe 9; dhe nenit 16, pika 1, shkronja ‘a’, ‘ç’ dhe ‘d’, të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë (më poshtë, ‘rregullorja 41/2019’), bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

**VENDOSA:**

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë është 0 (zero) për qind.
2. Bankat duhet të raportojnë shkallën e përmbushjes së shtesës kundërciklike të kapitalit sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, duke filluar nga data 31 dhjetor 2020.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**Gent Sejko**